



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:270553

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05379207

C.nr.469/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Morina-Lulaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit: A. T., nga fshati S..., Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson i autorizuari D. Z., avokat në P..., kundër të paditurës: Komuna e Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike: kompensim i shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit, vlera e kontestit: 708.85€, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

(Pa shqyrtim kryesor të çështjes)

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. T., nga fshati S... , Komuna Klinë.

II.DETYROHET e paditura Komuna Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A. T. , për kompensimin e shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 21.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 708.85€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.12.2023 (data e paraqitjes së padisë) të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëseve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë me datë 05.12.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim i shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën, isistemuar si mësimdhënës në SHFMU ‘Ymer Berisha, S..., Klinë. Në bazë të nenit 35 par 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim-pagesën e përqindjes në emër të inflacionit, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensojë shtesën në pagë në emër të inflacionit si vijon: për paditësin A. T. , për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 708.85€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, sipas tarifës së OAK-së, duke ia lënë gjykatës llogaritjen.

E paditura Komuna e Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj B. B. , në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 13.02.2024, ku ka theksuar se kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, për shkak të mos ekzistimit të bazës juridike dhe ligjore si dhe vlerës së lartcekur. E paditura ka theksuar se as Komuna e Klinës as DKA-ja në Klinë, nuk janë nënshkruese të kontratës së tillë kolektive të lëmisë së arsimit madje punëdhënësi Komuna e Klinës dhe DKA-ja e saj nuk e kanë të nënshkruar as Kontratën Kolektive adekuate të nivelit lokal siç e parasheh dispozita e nenit 90 par 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit të punës, pra Komuna e Klinës si dhe DKA-ja, përmes Organizatës sindikale të arsimit nuk e kanë të lidhur dhe nënshkruar një kontratë të tillë në nivel ndërmarrjeje apo si punëdhënës, krejt kjo do të thotë se në rastin konkret DKA-ja e Komunës së Klinës, në cilësinë e punëdhënësit në njërën anë dhe Organizata Sindikale komuna e arsimit, në anën tjetër nuk kanë të lidhur kontratë të tillë kolektive në kuadër të ndërmarrjes-lemisë së arsimit, prandaj e paditura nuk mund të merr përsipër kurrfarë detyrimesh të tilla të pa kontraktuara si këto pretenduese të paditësve. po ashtu i autorizuari i të paditurës ka theksuar se Komunës së Klinës dhe DKA-së, në kuadër të saj në veçanti i mungon legjitimacioni pasiv, në këtë rast konkret kontestimor juridiko-civil. Ka theksuar më tej se, kërkesa e paditësit është e parashkruar. Tutje, thekson se padia është e jashtëafatshme, sepse kanë kaluar mbi 5 vite, nga nënshkrimi i Kontratës Kolektive,

të vitit 2017 dhe datës së parashtrimit të padisë, në vitin 2023. Andaj ka kërkuar që padia dhe kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësi është themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse, të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nuk janë kontestuese faktet si në vijim:

Paditësi A. T. , i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHFMU ‘Ymer Berisha, S..., Klinë, si Mësimdhënës i Matmatikës, dhe paga bazë e tij është në lartësi prej 421.00€, fakte të vërtetuar përmes Kontratave të punës të lëshuara nga e paditura dhe lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë(KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej

që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës, sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, si në vijim:

Për paditësin A. T., gjykata pati parasysh ngritjen zingjirore të inflacionit ndër vite duke filluar llogaritjen nga viti 2021 deri në vitin 2022 (*brenda kërkesës së paditësit*), sipas përlllogaritjes si në vijim:

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 3.4% apo 171.72€ (421€ paga bazë x 3.4%=14.31x12 muaj =171.72€).

Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 11.6% apo 537.13€ (421€ paga bazë x 11.6%=48.83 x 11 muaj =171.72€).

E paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësve që t'ia kompensoj pagesën shtesë në emër të rritjes së inflacionit, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Sipas nenit 245 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parashihet se “kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësit A. T. , nuk i është përfshirë edhe shkalla e caktuar e infalcionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i

përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe se i mungon legjitimiteti real pasiv, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Pretendimin tjetër të të paditurës, lidhur me atë se Ministria e Financave, nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e pagës së punëtorëve është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevante se a prishet skema buxhetore e Komunës, për aq kohë sa e drejta e paditëseve për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzoi si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, pasi që paditësi përmes të autorizuarit të tij padinë e ka paraqitur me datë 05.12.2023, që nënkupton brenda afatit prej tri viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që paditësit i pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 124.00€, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00€, për taksën gjyqësore për padi, shumën prej 20.00 euro.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:270553
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05379207

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

C.nr. 469/23 i dt. 27.02.2024

Gj y q t a r j a
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.